Dandanes si nihče več v Jugoslaviji ne more mašiti oči in mižati pred kosovsko tragedijo. Vsi smo soodgovorni, v našem imenu pošiljajo na Kosovo tanke in specialne odrede. Skrajni čas je, da se slovenska uradna in neuradna politika končno odločno postavi po robu vse bolj cinično odkritim poskusom dckcnčnega zatrtja naših albanskih sodržavljanov. Položaj je že tako tragičen, da se Albanci še edinole v Sloveniji in deloma na Hrvaškem počutijo vsaj približno znosno. Ustanovitev albanskega kulturnega društva MIGJENI je sicer skromna, a vendar možnost, da bodo po eni strani Albanci sproščeneje zadihali in se čutili kot normalna skupnost, po drugi strani pa se bo tudi slovenska javnost ovedela, da v tem okolju živijo tudi drugi.

Jaša L. Zlobec

Populli shqiptar është sot në Jugosllavi në të gjitha aspektet në një gjendje jashtëzakonisht të rëndë. Në Kosovë duan pjesë-pjesë t'ia marrin autonominë, në Maqedoni kundër tyre nxjerrin ligje raciste. Thënë shkurt: në Jugosllavi shqiptarët praktikisht jetojnë si qytetarë të rendit të dytë. Ua mbyllën shkollat, ua decemojnë intelegjencien humanitare dhe teknike, pa përjashtim i marrin në pyetje, i keqtrajtojnë dhe i burgosin e i konfinojnë. Kjo politikë është thellësisht jonjerëzore, shkurtparëse e thjeshtë imbecile. Padyshim se shqiptarët heret a vonë do ta fitojnë sovranitetin e vet nacional e individual, porse me çfarë çmimi!

Sot e kësaj dite kurrkush në Jugosllavi nuk mund të mbyll sytë e të hesht para tragjedisë kosovare. Të gjithë jemi bashkëpërgjegjës, ngase në emrin tonë dërgohen në Kosovë tanke e njësi speciale. Është çasti i fundit që politike zyrtare dhe jozyrtare sllovene përfundimisht dhe vendosmërisht t'i vihet ndesh përpjekjeve gjithnjë më të hapura e cinike të shtypjes përfundimtare të bashk-atdhetarëve tanë shqiptarë. Pozita është tashmë aq tragjike sa shqiptarët vetëm në Slloveni e pjesërisht në Kroaci ta ndjejnë veten pakashumë të lirë. Themelimi i shoqatës kulturore Migjeni është mundësi modeste, porse prapeseprap mundësi që në njërin anë shqiptarët të frymojnë lirshëm e të ndjehen si bashkësi normale, e në anën tjetër opinioni slloven të kuptojë se në këtë ambient jetojnë edhe të tjerët.

Jasha L. Zlobec

Masat e jashtëzakonshme

KOSOVA - REPUBLIKË

Kryesia e tashme e Jugosllavisë javën e kaluar e vazhdoi masat e jashtëzakonshme (gjendje e jashtëzakonshme, masa të posaçme-terma që as tani, nuk i sqaruan), të cilat e mëparshmja i aplikoi kundërligjshëm, Kuvendi Fëderativ në bazë të dezinformatës së anëtarit të kryesisë së mëparshme, Mojsovit, i aprovoi, më qllim që më lehtë të pranohen ndryshimet e dyshimta kushtetuese në Kosovë. Mbështetje për tu vazhduar masat e tilla janë "paraqitje të reja nga pozita të nacionalizmit e të seperatizmit shqiptar, në të cilat ka edhe elemente terrorizmi". Poashtu Kryesia konstatoi se bashkëjetesa e kombeve e kombësive në Kosovë varet nga aksione të gjera e të menduara mirë politike. Po çfarë janë ato aktivitete?

Po pranuar pohimin e Milosheviqit se populli serb edhe pse i dehur nga fitoret, nuk do të qëndrojë në vend, mund të mendojmë se do të bëjë edhe më tutje hapa të tjerë të dehur fitimtarë dhe do ta rregullojë fizionominë e botës në përshtatje të syve të tij. Është e vërtetë se ilaçi më i mirë për të mposhtur mamurllëkun pasi të jeshë bërë tapë një ditë më parë, është të vazhdosh pijen edhe më tej (kushdo që ka pirë ndonjëherë e di atë fjalën se pyka-pykën e shtyn), kështuqë bota ndrron e përshtatet sipas dëshirave tua. Po e bëre këtë për shkak të alkoholit të tepërt të pirë, është, çështje individuale, aniqë një veprim i tillë nuk është në perputhje me bontonin. Problemi lind kur asaj pamje të shtrembëruar të botës i bashkohet dëshira politike për të rregulluar jetëra të tjera, si dhe gatishmëria e atyre që kanë fuqi që të ndihmojnë në atë drejtim. Përafërsisht në pozitë të tillë jemi sot jo vetëm në Kosovë po në gjithë Jugosllavinë.

Masa e fundit e Kryesisë vërteton këtë. Të sëmurit, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk ishte aq i sëmurë, ju përcaktua ilaç i gabueshëm. Mjeku në vend se pas kontrollit të ri të përcaktojë sëmundjen e vërtetë e ta ndërrojë diagnozën e me të barërat, pohon se vetëm doza e ilaçit (helmit-sepse dimë se çdo ilaç është njëherit helm) është e paktë, shërimi i shkurtër. Prandaj shton ilaçet e vazhdon mjekimin. Deri tek kontrolli tjetër kur

do të përsëritet e njëjta gjë. Natyrisht se i sëmuri një shërimi të tillë heret a vonë do ti nënshtrohet. Fajtor, merret vesh, nuk do të jetë mjeku po ai që përzihet në punën e tij.

Si ta kuptojmë ndryshe marrjen e vazhdimin e masavnë Kosovë? Tërë ditën para se të vazhdoheshin masat e jashtëzakonshme, dëgjuam përmes radios se në Prishtinë e vende tjera janë dukur parulla, si: "Kosova-Republikë", "Poshtë Milosheviqi" e të ngjashme, çka ishte si parapërgatitje për atë masë. E dimë pikë për pikë se vazhdimi i masave të jashtëzakonshme dhe gjithë asaj që përcjell atë (diferencimi-hedhja vetëm e intelektualëve shqiptarë e të ekonomistëve në rrugë, izolimi e burgosja prap vetëm e shqiptarëve, realizimi i ligjeve të apartheidit mbi punësimin pa konkurs të serbëve e të malaziasve, mbi pensionimin para kohe të arsimtarëve shqiptarë, emrat e të posalindurve, mbi vërtetimin për vlerat moralo-politike për punësim e shkollim, etj., etj..) vetëm se do ta shtojë numrin e parullave të tilla e të ngjashme, elementet e terrorizmit do ta humbin pjesën elemente, do të shtohet frika e urrejtja midis popujve në Kosovë, ngaqë njëra palë do të ndjehet e shtypur e tjetra e paprekshme, serbët e malaziasit do të shpërngulen edhe më tej, etj. Këto, mirret vesh, do të kërkojnë prapë vazhdimin e ashpërsimin e masave të jashtëzakonshme...

Politika e tillë është e sukseshme vetëm për arritje të një qëllimi qëndrimit në pushtet vetëm me ndihmën e armikut të brendshëm a të jashtëm. Se ekzistimi i armikut (me kontroll informatash e indoktrinim total) është metoda më e thjeshtë e mbajtjes në pushtet të atij pushteti që popullit të vet nuk di e nuk mundet t' i ofrojë asgjë, ngaqë mbështet në ideologji joreale duke parë botën me sytë e pijanecit, siç e ka përshkruar Orweli. E vërtetë është se kanë kaluar nga ajo kohë pesë vite. Deshe s'deshe duhet të këndellesh.

Çfarë t'i porosis atëherë Kryesisë së Jugosllavisë? Të shohë më në fund se i sëmuri nuk është edhe aq i sëmure, se lëngon veçse nga disa sëmurje fëmijësh që duhet t'i tejkalojmë të gjithë

pó deshëm të jetojmë. Ashtu si duhet ta kemi të qartë se fëmija nuk ka asgjë të keqe poqese i vjedh dhe fshehtas lexon farë literature pornografike, edhe politika jugosllave duhet ta ketë të qartë se është krejt e natyrshme për akëcilën shoqëri demokratike kur sheh në mur parullën KOSOVA - REPUBLIKË!

Dnevnik, 13 qershor 1989.

Matjash Hanzhek

Përkthei: SK

Zahvaljujemo se Dušanu Sivcu, ki je tehnično uredil ALTERNATIVO, in vsem drugim, ki so tako ali drugače pripomogli k izidu našega glasila.

UREDNIŠTVO

Falenderojmë Dushan Sivcin, që e përgatiti teknikisht ALTERNITIVEN si dhe të gjithë të tjerët, që ashtu apo kështu ndihmuan daljen e fletushkës sonë.

REDAKSIA

Ali PODRIMJA

FAJTOR ËSHTE SHQIPTARI

Fajtor është shqiptari
që merr frymë
e ec në këmbë"

Unë që pi medikamente për qetësim
e tërë kohën gjuaj miza
në Nevojtores

Fajtor është shqiptari
që shkryen gruan e vet
e familjen time shqetëson

Mollën që s'e arrin dora ime
në degën më të lartë
me fjalë të vdekura që mbushi Pusin

Fajtor është shqiptari
që s'ekzistojnë më shumë Turqi
më shumë Amerika Norvegji

Gulagu që është aq larg

Që më zgjidhën e më lëshuan
të nuhas pas tij
A nuhatet vdekja

Fajtor është shqiptari
më shumë që nuk ha
e nuk fus gjumë sy

Kanalizimi ynë që plasi
e Katakombet e Ballkanit
u rrënuan

Fajtor është shqiptari
që vizaton fytyrën e vet nën hënë
e thyen dritare e trazon ujin e ndotë

që flet shqip që ha shqip që dhihet shqip

Fajtor shtë shqiptari
shqiptari është fajtor
për të gjitha rëniet e mia

Edhe për dhëmbin tim të prishur
edhe për buzëqeshjen time të ngrirë
prandaj prandaj PLUMB

Ha ha ha
ha ha
ha

Fal të qofsha Zoti im

KDAJ BOŠ SPREGOVORIL O ALI PODRIMJA

Na dlani ugaša zvezda
naravnost v oči nas gledaš in požiraš
tvojega hrbta nikoli nismo videli o Ali Podrimja

Stojiš pod mrzlim nebesom in molčiš že leta
še verjameš
v človeka

Ime ti ponarejajo
priimek in podpis in rojstni list
ime očeta matere prednikov rodni kraj
otroške pravljice igrače
heroje žalostinke praznike

Tvojemu jeziku staremu in rodu
se rogajo
s hudourniki črnih laži

Ti pa molčiš o Ali Podrimja
še verjameš
v človeka

V mračnih izbah v kletih srednjeveštva
snujejo elaborate pošastne etikete prekletstva
hajke pregone selitve
divji lov

Sveče gori in se utrnejo diši kadilo kapljajo besede telesa
skrivnosti

z glavo v torbi na tuje hodijo otroci
žena tke sukno in ga para
v Stolpu iz papirja

Ti pa molčiš o Ali Podrimja
še verjameš
v človeka

Daljša se senca nad glavo vrane na nebu krokarji
svetle kodre si razčesavaš
z grudo prsti v nedrih
na dolgo dolgo pot se podajaš .

V mondeni Evropi si Albanais
Arbreš v Italiji Arvanitas v Grčiji
v Turčiji hvala bogu Arnavt
v Ameriti konzervirano meso
in nič več in nič več

Kdo ve koliko jeziko govori tvoj bog

Ti pa molčiš o Ali Podrimja
še verjameš v človeka

Ampak ampak
kdaj bo končno spregovoril človek
ali pa se moraš najprej roditi

Prevod: Jaša Zlobec

Dane ZAJC

KARAXHA I MADH

Karaxha i madh i bërlyket mëngjesit.

Karaxhë, cilin thërret?

Kullosat janë të lëshuara.

Majat janë boshe.

Bosh janë gropat.

Boshe si jehonë e thirrjes tënde.

Karaxha i madh i bërlyket mëngjesit.

Thua spërkat gjak i rëndë i zi

në piptha pishash të vrugëta.

Thua se sipër pyllit në lindje

hapet në mëngjes

syri gjak i karaxhës.

Karaxhë i madh, kë thërret?

Eshtë kënaqësi të dëgjosh

si kthen jehonë

thirrja jote heshtake?

Karaxhë, pa gjak është mëngjesi.

Zëri yt përplasat gropash

si tufë e hallakatur

sorrash të zeza.

Askush s' dëgjon vetminë tënde.

Asnjërin s' e ngop

me gjak të zi të zërit tënd.

Hesht, karaxhë i madh i zi.

Karaxha i madh i bërlyket mëngjesit.

Dielli në lindje mpreh

sopatën vezulluese të kasapit.

Nga sllovenishtja: Salih KABASHI

Veno TAUFER

PËRBALLË ZGAFELLËS

i përllamë eshtrat tanë
deri tek bardhësia klithëse
shtruar në zgafellën babaxhane
bukurinë e egër të bolshevikut plak

përcjellës thatanikë shtrojmë
në varr edhe armët e tij të harlisura
me dhëmbë të pikëllimit sapo të mprehur

o do të thyhen arkivole sysh
me boshësi të zeza
do të vërsulën
gentë e tërbuar

gentë e tërbuar
që i ulërujnë nënës
në shpirtin tonë

ç do rrahje zemre
do të nxjerrë
cuba të rinj të çartur

Nga sllovenishtja: Salih KABASHI

Libra të rinj

Nove knjige

KOSOVA-SERBIA-JUGOSLAVIA

(botim i KRT-it, Lubjanë 1989)

Libri në shqyrtim është në të vërtetë një përmbledhje kontributesh shkencore të parashtruara brenda dy ditësh (më 12 e më 13 janar të k.v.) në një nga sallat e Cankarjev Domit në Lubjanë. Në pjesën e dytë të librit janë të dhënat e një hulumtimi shkencor të kryer nga Varianta e nga KRT-i e Mladina. Është e tepërt të flasësh për vlerën shkencore të librit. Mjafton të kujtojmë se brenda fageve të tij ndeshemi me një sërë emrash kulminativë të shkencës kosovare, sllovene e jugosllave: Fehmi Aganin, Muhamedin Kullashin, Rudi Rizmanin, Gani Bobin, Branko Horvatin, Hivzi Islamin e Rexhep Ismajlin e të tjerë. Kumtesat që ishtruan në atë tubim e që kanë gjetur vendin e tyre në libër, trgojnë sa i nevojshëm është një kundrim shkencor problematikës kosovare e cila siç dihet është e përmytur me paragjykime e pseudoshkencë që thënë butë bie erë shovinizmi brutal.

Edhe Shkëlzen Maliqi, Slobodan Samarxhiq, Isuf Berisha, Lev Krefti, Lino Veljak e Jasha Zlobec e sidomos rezultatet e prezentuara nga hulumtimi i disponimit të opinionit në Kosovë trgojnë ashtu siç dëshmuar ngjarjet e shkurti e gjakderdhja e marsit, JO-në e MADHE E TË ZËSHME PUSHTETIT TË MILLOSHEVIQIT? JO-në QË E MORI VESH GJITHË BOTA.

Në fund: B l e n i e l e x o n i s i d h e p ë r h a p n i k ë t ë l i b ë r s e m e k ë t ë p ë r h a p n i t ë v ë r t e t ë n p ë r K o s o v ë n , S e r b i n ë e J u g s l l a v i n ë .

P.S. Pjesëmarrësi në Tubimin e përmendur shkencor, linguisti i shquar shqiptar, përkthyesi e profesori universitar, Rexhep Ismajli, sot e kësaj dite gjendet i izoluar diku në Serbi...Pse? Përgjigjen para opinionit demokratik duhet ta japë politika uni(tariste)ke e Republikës serbe dhe xhonshqiptarët në ish-krahinën autonome.

Salih Kabashi

Pri Časopisu za kritiko znanosti sta izšli prvi dve knjigi iz trilogije Srbija in Albanci (v srbohrvaščini). Prva knjiga obravnava politiko Srbije do Albancev v obdobju 1878-1914, druga pa v obdobju 1913-1945. Tretja knjiga, ki je tik pred izidom, naj bi po obljubah založnika segla do današnjih dni.

Avtorji iz Beograda - zaradi lastne varnosti so ostali anonimni - so knjigi pospremili z ironičnim posvetilom: "Svi navedeni izvori u ovoj knjizi su srpski i dostupni su svakom građaninu Beograda, npr. članu Narodne ili Gradske biblioteke." Delo je namreč sestavljeno iz samih citatov iz srbskega tiska in iz srbskih knjig, od Dimitrija Tucovića pa vse do Vladimirja Dedijerja in Dimitrija Bogdanovića, da zloglasnih memorandumov Vase Čubrilovića niti ne omenjamo. Vsekakor bi bilo avtorjem nemogoče očitati, da so črpali iz sovražnih, velikoalbanskih virov. Knjigi sta v vsakem pogledu pretresljivi: na osnovi dokumentov lahko bralec z grozo spremlja stoletno trpljenje albansekga naroda tako na Kosovu kot v Albaniji. Srbski imperializem, ki je doživel prvi vrh v albanskih vojnah, se ni nikoli odrekel svojim ekspanzionističnim načrtom. Najhuje so jo pri tem nedvomno odnesli prav Albanci. Ko boste prebrali to knjigo oziroma trilogijo, se ne boste več mogli sprenevedati, da ne veste, kakšne so korenine kosovske tragedije.

Jaša L. Zlobec

Ky libër i vogël me njëzetë e tri poezi, edhe po të mos u ishte kushtuar pikërisht "Minatorëve kosovarë", nga diksioni e pjesërisht leksiku i tij, do të qartësonte se "Gjarpëri nën gur" i kushtohet atij trolli të mjerë. Shtytja themelore inspiruese, kësisoji, është aktualiste, bile edhe natyraliste (fotografia në kopertinë!), mirëpo midis atyre poezive, të shkruara, siç duket, në tronditje të çastit që afron me afektin, mëkot do të kërkonim lëndë politike a sociale, aq më pak kategori të qarta ideologjike. E vetmja kornizë e këtij intervenimi poetik është humanizmi, formë e dukurisë së tij janë tmerritja dhe solidariteti autentik. Dhe duhet shtuar menjëherë: ndjesia në këto poezi të Kozincit s'është sentiment që gjakon referenca populiste, por është akuzë e pjekur dhe e balancuar, e cila, filluar në rrafshin e ngjarjeve, arrin kornizat e tij civilizuese e mitologjike. Aq sa ajo është vënë në realitet të drejtëpërdrejtë politik, për aq është ngritur në rrafsh simbolik të keqes brutaliteti i saj. Për këtë arsye metaforika e Kozincit nuk mundëson lexim tjetërfare të "Dramës kosovare", porse këtë dramë e vendosë në distancë historike që pranon një gjyqtar të vetëm - njerzishmërinë.

Duhet thënë diçka. Kozinci në shumicën e poezive nuk flet nga pozitativat e subjektivit të vetës së parë, a kur megjithatë rrëmbehet, atë e bën në atë mënyrë që të shihet qartë edhe drama intime e subjektivit, ku janë në dispozicion "iluzionet e humbura" të dramës që ka besuar në historinë. Mu për këtë arsye "Gjarpëri nën gur" është një takim i pasforcuar me një përpëlajtje vetanake e mbiindividuale; në të dy rastet kemi të bëjmë me lindjen e deziluzionit. Pozitivë të këtillë, këtë përfolje të intimes e të historisë, poezia sllovene, ka pasur vetëm në kohërat më të eksponvara të sajë.

Peter Kollshek

Së shpejti:

Fjalor bashkëkohor SHQIP-SLLOVENISHT e SLLOVENISHT-SHQIP

Pas më se 70 vjet jetese në jugosllavitë e para e pas luftës, i riu Nikollë Berishaj në shtator të këtij viti del me fjalorin e lartëshënuar, që padyshim paraqet një ngjarje të rëndësishme jo veç për autorin porse për gjithë kulturën shqiptare. Fjalori në fjalë përmban 12.000 fjalë sllovene e 11.000 shqipe çka assesi nuk flet për mangësinë e shqipes për 1000 fjalë... Mbi njëmijë shprehje nga jeta e përditshme sllovene-shqiptare, janë ndihmesë edhe për kureshtarit si për shkencëtarin. Libri në fjalë do të jetë ndihmesë si për shqipfolësin ashtu për sllovenin kureshtar për shqipen.

Libri, fjalori, del në shtator dhe e boton CANKARJEVA ZALOŽBA. Pra, nga shtatori, do ta kemi më lehtë, apo jo!!!

SK

V kratkem bo pri založbi KRT izšla študija Martina Berishaja MEDNARODNI POMEN PRIZRENSKE LIGE. Naj za začetek objavimo samo dva kratka odlomka iz recenzij.

"(...) Iz sorazmerno dokaj močno členjenega programa raziskave, kot je razviden in vsebinskega kazala, izstopajo naslednji sklopi problemov: oblikovanje ideje o albanski avtonomiji znotraj turškega imperija in vloga notranjih ter zunanjih dejavnikov, odprtje vzhodne krize in njeno mesto na Berlinskem kongresu, nastanek Prizrenske lige in odmevi nanjo v mednarodnem okolju. Izvedbo tega programa moramo oceniti kot pregledno, razumljivo, argumentirano in koherentno. (...)"

"(...) S to knjigo bomo v Sloveniji končno dobili strokovno informacijo o zgodovinskem razvoju, ki bo ob zgodovinski vednosti vključevala tudi marksistični pristop k nacionalnemu vprašanju albanskega naroda v devetnajstem stoletju, Knjiga bo poleg javno informativne imela tako tudi posebno strokovno in politično vrednost in bo gotovo vzbudila širok interes. (...)"

Avtorja recenzij sta prof. dr. Vlado Benko in dr. Lev Kreft

Odbor za zaščito človekovih pravic na Kosovu

Këshilli për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë

Hočemo takšno skupnost, v kateri bodo vsi ljudje živeli v svobodi, miru, slogi in enakopravnosti - ne glede na spol, vero, nacionalnost in politično prepričanje. Danes na Kosovu ni ne svobode ne miru ne enakopravnosti.

Stopnja civiliziranosti posamezne državne skupnosti se danes v svetu meri po tem, kolikšne pravice imajo manjšine. Dolžnost večin je, da manjšini omogoča varno in v vseh pogledih svobodno življenje. Do nobene odločitve v zvezi z manjšino ne sme priti brez njene volje ali celo proti njej. Albanci so pri nas manjšina tako v Jugoslaviji kot v SR Srbiji. Srbi in drugi narodi so manjšina na Kosovu. Eni in drugi so torej v dvojni vlogi, zato bi morali biti medsebojna strpnost in razumevanje še toliko večji.

Vsi vemo, da na Kosovu že dolgo ni tako. Medčloveški in mednacionalni odnosi postajajo iz leta v leto, iz dneva v dan slabši. Vse bolj se množijo elementarne kršitve osnovnih človekovih pravic. Zaradi tega smo hudo zaskrbljeni, pa naj so kršene pravice Črnogorcev ali Albancev, Srbov ali Romov, Hrvatov ali Muslimanov. Ni pomembna nacionalnost, pomembni so ljudje. Zato si bo naš odbor prizadeval dokumentirano opozarjati na vse kršitve človekovih pravic na Kosovu. Kosovo je v tem trenutku pri nas najhujša rana kršitev človekovih individualnih pravic in pravic narodov, in že kaže svoje neposredne vplive na celo državo. Prizadevanje za človekove pravice terja od nas, da vso svojo energijo in pozornost posvetimo prav najbolj bolečemu delu v državi. Prepričani smo, da lahko le pravna država, ki ne diskriminira nobenega svojih državljanov in nobene nacionalne skupnosti, normalizira razmere na Kosovu.

Pozivamo vse ljudi dobre volje, vsa društva in vse organizacije po celi Jugoslaviji, ki soglašajo z našimi izhodišči, naj se pridružijo našemu odboru.

Ljubljana, 15.3.1989

Iniciativna skupina za Odbor za zaščito človekovih pravic na Kosovu

Kolektivni člani:

1. Odbor za varstvo človekovih pravic,
2. Svet za pravičnost in mir pri slovenski medškofovski konferenci,
3. Debatni klub 89,
4. Delovna skupina za mirovna gibanja pri RK ZSMS,
5. Sekcija za kulturo miru pri ŠKUC,
6. Društvo likovnih umetnikov iz Zveza društev likovnih umetnikov Slovenije,
7. Radio Študent,
8. Univerzitetni komite ZSMS Ljubljana,
9. Univerzitetni komite ZSMS Maribor,
10. Delovna radikalna skupina za združene države Evrope pri RK ZSMS,
11. Jugoslovanska skupina Mednarodne helsinške federacije za človekove pravice,
12. Socialdemokratska zveza Slovenije

PROGRAM

I shoqatës kulturore të shqiptareve »MIGJENI« të Ljubljanes

Shoqata vepron në gjashtë seksione:

- seksioni letrar
- seksioni muzikor
- seksioni dramës
- seksioni i përkthyesve
- seksioni sportiv
- seksioni informativ.

Pasqyrë pak më e përafërt e veprimit të seksioneve.

1. SEKSIONI LETRAR

Seksioni letrar do të organizojë mbrëmje letrare me anëtarët e vet, me shkrimtarët shqiptarë e me krijues të kulturës nga vendi dhe bota, me shkrimtarë sllovenë e me krijuesit kulturor nga vendi dhe bota, me shkrimtarë e krijimtarë të kulturave të tjera nacionale nga vendi e bota.

Seksioni letrar do të nxjerrë një herë në muaj fletushkën ku do të pasqyrohet puna e Shoqatës si dhe do të botohen tekste të anëtarëve të vet, të bashkëpunëtorëve e të musafirëve të Shoqatës.

Seksioni letrar do të organizojë tribuna e mbrëmje në të cilat do të marrin pjesë shkrimtarë, punëtorë kulturorë e publikë nga Sllovenia, vendi e bota. Do të jenë ato paraqitje letrare si dhe biseda për kulturën e për aktualitetet nga politika e kultura me theks zhvillimi e pozita e kulturës shqiptare në Jugosllavi e në botë. Seksioni do të ngrisë një bibliotekë shoqërore me libra shqiptarë e me vepra të rëndësishme nga letërsia sllovene, botërore si dhe nga letërsitë e popujve të tjerë jugosllavë.

Seksioni do të organizojë promovimin e risive letrare nga letërsia shqiptare e sllovene. Do të organizojë edhe ekspozita piktorësh e skulptorësh shqiptarë. Do të mbahen sipas rastit edhe mbrëmje solemne letrare me rastin e ngjarjeve me rëndësi nga kultura shqiptare e sllovene.

Seksioni në punën e tij do të bashkëpunojë me Shoqatën e Skrimtarëve Sllovenë, me Lidhjen e Organizatave Kulturore e me shoqata të tjera simotra.

2. SEKSIONI MUZIKOR

Seksioni muzikor do të përgatisë e do të organizojë paraqitje për anëtarët e vet e për lubjanasit, do të shkojë edhe në vise të tjera të Sllovenisë ku do të shfaq muzikë burimore, popullore e zbavitëse. Do të organizojë, për anëtarë të vet e për musafirë, pjesëmarrje grupesh e shoqërisht kulturore-artistike.

Seksioni muzikor do të organizojë promovimin e pllakave e të kasetave të grupeve muzikore nga Sllovenia e nga vise të tjera të Jugosllavisë.

3. SEKSIONI I DRAMËS

Seksioni i dramës do të organizojë e do të shfaq drama e recitale për anëtarë të Shoqatës, musafirë e banorë të Lubjanës. Me programet e veta do të vizitojë edhe vende të tjera nëpër Slloveni e Jugosllavi.

4. SEKSIONI I PËRKTHYESVE

Seksioni i përkthyesve do të merret me përkthimin e letërsisë e të beletristikës nga shqipja në sllovenishte dhe anasjelltas me c' rast do të bashkëpunojë me Shoqatën e Përkthyesve Letrarë të Sllovenisë, do të përgatisë tekste të nevojshëm dygjuhësor për punën e Shoqatës dhe informimin e anëtarëve të tij.

(Që nga fletushka e tutje).

5. SEKSIONI SPORTIV

Seksioni sportiv në kuadër të mundësive të tij do të formojë ekipe futbollit, basketbollit etj.. Ato ekipe do të jenë pjesëmarrëse në gara të ndryshme e kampionate regjionale si dhe do të organizojë gara të ndryshme me raste festash të ndryshme. Brenda seksionit sportiv do të themelohet edhe grupi i shahistëve, ngase mendohet se në lokalet e Shoqatës do të jenë në dispozicion disa garnitura shahu. Natyrisht se do të organizohen turne shahu.

6. SEKSIONI PËR INFORMIN


Seksioni për informin do të lajmërojë mbi punën e Shoqatës. Njëherit do të përcjellë ngjarjet kulturore nga fusha e kulturës shqiptare e sllovene si dhe ajo jugosllave (mirret vesh edhe ato nga bota e jashtme) dhe për to do të informojë anëtarët e

saj. Poashtu Seksioni për informim ka për detyrë që në lokalet e Shoqatës të vijnë shtypi i përditshëm e ai periodik nga gjithë Jugosllavia e bota e jashtme.

Që të jetë më e larmishme jeta shoqërore në lokale të Shoqatës do ta ketë vendin edhe një televizor me video. Në video kasetat do të ipizohen ngjarje të ndryshme nga kultura shqiptare e sllovene si dhe nga kulturat e popujve të tjerë jugosllavë.

Shoqata që të degëzojë aktivitetin e sa do të ketë nevojë për mjete të caktuara financiare. Pasi që Shoqata pos anëtarësisë e kontributeve të anëtarëve të saj dëshiron të vetëfinancohet, kemi ndërmend të hapim nje buffe të vogël në lokalet e saj ku do të shërbehet pije joalkoolike e diç tjetër për të grimtuar me çmime më të ulëta se në lokalet publike.

ALTERNATIVA, fletuskë e Seksionit Letrar të Shoqatës Kulturore Shqiptare "MIGJENI", glasillo literarne sekcije Kulturnega društva Albancev v Ljubljani MIGJENI. Kryeredaktor e redaktor përgjegjës, glavni in odgovorni urednik: SALIH KABASHI. Redaksia, uredništvo: Salih Kabashi, Nikollë Berishaj, Jaša Zlobec, Gani Lipaj, Zdravko Duša, Fadil Demiri, Peter Božič, Shkëlzen Maliqi, Matjaž Hanžek, Naim Maloku. E shtypi, natisnila: Cveta Skušek, Plečnikov podhod, Ljubljana; Botoi, izdala Univerzitetna konferenca ZSMS Ljubljana; për të, zanjo: Gorazd Drevenšek. Përgatitja, oprema: Salih Kabashi. Adresa e përkoshme e Shoqatës dhe e revistës, začasni naslov društva in glasila: Zveza kulturnih organizacij, Mestni odbor, Krekov trg 2, Ljubljana. Kontributet vullnetare mund ti dërgoni në; prostovoljne prispevke lahko pošljete na žiro račun: LB 50101-678-47303, za šifro 15 (odbor za zaščito človekovih pravic na Kosovu). Çmimi i copës, cena izvoda ALTERNATIVE: 15.000 din.



Migjieri